



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:238721
Datë: 30.10.2024
Numri i dokumentit: 06375928

C.nr.4367/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtorin profesional Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K.M. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.A-S., avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi në emër të kualifikimit, vlera e kontestit 996.30 euro, jashtë seancës, me datë 29.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses K.M. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kualifikimit bachelor për periudhën 01.08.2021 – 31.01.2023, për 18 muaj, duke llogaritur nga 55.35 euro për çdo muaj, t’ia paguaj paditëses shumën prej 996.30 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 30.08.2024 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuares së saj, më datë 30.08.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin në emër të kualifikimit, në vlerë të kontestit prej 996.30 euro.

Në padi ka theksuar se e njëjta është e punësuar në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët (në vijim: SHFMU) “Thimi Mitko” në Gjilani, në cilësinë e mësimitdhënëses, sipas kontratës së punës me kohë të pacaktuar. Përkundër kualifikimit të saj bachelor, nuk është kompensuar për aq sa e përcakton baza ligjore për kualifikim nga e paditura si punëdhënëse, edhe pse ky ka qenë detyrim i së njëjtës. Për periudhën 01.08.2021 – 31.01.2023, e njëjta është kompensuar vetëm në shumën prej 58.32 euro për çdo muaj, ndërsa është dashur të paguhet në shumën prej 113.67

euro (sipas 27 % të pagës bazë), me ç'rast e paditura ia ka mbetur borxh në shumën prej 55.35 euro në muaj. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 21.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 10.07.2024 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese që kanë të bëjnë me paditësit e sektorit të arsimit, të mbështetura në Kontratat Kolektive të Arsimit të vitit 2017 dhe 2021 dhe Vendimin e Qeverisë të vitit 2008, sa i përket kërkesave për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit, inflacionit, diferencës në pagë në bazë të kualifikimit, e pagës jubilarë. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të kualifikimit/licencës, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Sa i përket kompensimit për orë shtesë mbi normën e punës, kjo kërkesë nuk gjen mbështetje ligjore, si dhe kontrata kolektive në fjalë zbatohet vetëm deri më datë 21.11.2022, andaj çdo kërkesë pas kësaj date duhet të refuzohet. Sa i përket kompensimit për punë gjatë vikendit (pandemi), bazuar në vendimin e MASHT-it, nr.01b/292 të datës 28.09.2021 paditësit kanë qenë të obliguar që ditët e humbura punuese gjatë kohëzgjatjes së pandemisë t'i zëvendësojnë, e në rastin konkret kemi të bëjmë me orë të zëvendësuar, e jo orë shtesë. Ka konsideruar se paditësit nuk kanë shtjerrë paraprakisht mjetet e brendshme të ankimimit, bazuar në nenin 78, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie punë tek e paditura (fakt i vërtetuar nga kontrata e punës në kohë të pacaktuar, nr.prot.1378 e dt.01.09.2015 dhe vërtetimi nr.prot.04/145 i dt.06.02.2024 i lëshuar nga SHFMU “Thimi Mitko” në Gjilan).

Nuk është kontestuese se e njëjta ka diplomë të nivelit Bachelor nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit (fakt i vërtetuar edhe nga diploma nr.17 e dt.15.06.2015), është

mësimdhënëse e licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.1000000881 e dt.11.09.2012) dhe se pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 58.32 euro (fakt i vërtetuar edhe nga lista e lëshuar në emër të paditëses nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga kjo, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me Bachelor, pasi është paguar në shumën prej 58.32 euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 euro, me ç'rast i ka mbetur borxh në shumën prej 55.35 euro, ndërsa periudha e kërkuar për këtë kompensim përfshin kohën sa ka qenë në fuqi Vendimi i Qeverisë dhe nuk është nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 30.08.2024, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga data 01.08.2021.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim. Edhe sa i përket pretendimeve se paditësja nuk i ka shtjerrë mjetet e brendshme të ankimimit, gjykata vlerëson

se në kategorinë e të drejtave nga marrëdhënia e punës sa i përket kompensimit monetar, mund të adresohet kërkesa drejtpërdrejtë në gjykatë, pa u ndjekur fare procedura e brendshme administrative.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.4367/24, më datë 29.10.2024

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.